



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr.04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt.22 Nëntor 2012, nenit 37, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjiçanit, për qëllimin e sigurimit të tokës për interes publik- hapjen e rrugës dhe ndërtimin e rrethrotullimit tek Lagja "Iliria" në Gjiçan, (Projekti i Rrugës "Jugu I, faza e II-të), pas Rekomandimit të Komitetit për Pronë dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, për këmbimin e pronës komunale me pronën private, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në seancën e mbajtur me date 29.11.2016, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të Rrethrotullimit tek Lagja "Iliria" (Projekti i rrugës "Jugu I, faza II) - Gjiçan

1. Kuvendi i Komunës **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën private për nevoja të sigurimit të tokës për interes publik- Rrethrotullimi në Lagjen "Iliria" (Projekti i Rrugës "Jugu I, faza e II-të) - Gjiçan**
2. **Lejohet këmbimi i pjesëve të ngastrave kadastrale:**
 - P-70403013-05143-0, lloji i pronës - pronë shoqërore, zona - urbane, e cila gjendet në vendin e quajtur "Livadhet e Arapit", Zona Kadastrale Gjiçan, me sipërfaqe prej 19155 m², e evidentuar në emër të P.Sh.Kuvendi i Komunës Gjiçan,
 - **Sipërfaqja 295 m² e ngastrës kadastrale, P-70403013-02514-1, lloji i pronës- private, zona- rurale, nga sipërfaqja e parcelës prej 2682 m², te vendi i quajtur "Krivaça" , Zona Kadastrale Gjiçan, e bashkëpronarëve: Bajram (Bajrush) Ahmeti, pjesa e pronës ½ dhe Asllan (Aziz) Asllani, pjesa e pronës ½.**
3. Prona private e përshkruar në pikën II të këtij Vendimi është shpallur **Interes i Përgjithshëm Publik** me Vendimin e Kuvendit Komunal 01.nr.16-5760 të datës 27.4.2011 dhe është pjesë e Projektit të realizuar "Jugu- I, faza e II-të, kurse prona komunale është përfshirë me Planin Rregullues Urban " Livadhet e Arapit" dhe këmbimi i këtyre pronave bëhet në përputhje me këto plane, sipas destinimit të paraparë .

4. Obligohet Kryetari i Komunës, që pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi të bëjë kërkesë Ministrisë për Financa-ZVPP për vlerësimin e pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i këmbimit dhe të lidhin Kontratë për këmbimin me pronarin privat të cekur në nenin II të këtij vendimi duke u bazuar në raportet e vlerësimit nga Ministria përkatëse.
5. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë parcelimin e ngastrës Komunale sipas raportit të vlerësimit dhe pas lidhjes së kontrates mes Kryetarit të Komunës dhe pronarit privat të bëjë regjistrimin e pronave të këmbyerë në Regjistrat Kadastral.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.
7. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 016-117674
Gjilan, më 29.11.2016

Kryesuesja e KK-Gjilan

/Valentina Bunjaku-Rexhepi/